



## Center System Thermo Capot

- ◆ Ngjitës për realizimin e sitemeve termoizolues ETICS (Kapotë). Është i përbërë nga Çimento 52,5R, inerte mermeri me granulometri të seleksionuar, rezina sintetike, fibra përforcuese si dhe aditivë të tjerë special të cilët përmirësojnë puneshmërinë, forcën ngjitëse dhe hidrofobicitetin e llaçit të ngurtësuar.
- ◆ I përshtatshëm për ngjitjen e paneleve të polisterolit, grafitit, poliuretanit, fibrave minerale, leshit të xhamit, në suporte prej tulle, betoni ose llaçi me bazë çimento. Rrafshimi i paneleve duhet të kryhet në dy duar duke e kombinuar me vendosjen e rretës prej fibra xhami midis dy duarve.
- ◆ Sipërfaqja ku do të aplikohet duhet të jetë e pastër pa bojra, vajra, pluhura etj. Para se të filloje ngjitja e paneleve rekomandohet të fiksohen profile metalike mbajtes te niveluar. Në sipërfaqe të parregullta si në mure tulle të pa suvatuar ngjiteshi aplikohet me mistri duke u vendosur anash në forme shiriti dhe në disa pika ne qender te panelit. Ne sipërfaqe te rrafshëta ngjiteshi duhet të hapet në të gjithë siperfaqen e panelit me malla të dhembëzuara. Panelet duhen vendosur në mënyre horizontale nga poshte lartë duke patur kujdes ne bashkimin e tyre për të mos lënë hapsira bosh dhe disnivele. Më pas bëhet fiksimi mekanik me upa (ne 8 pika /m2)

### Pergatitja.

Në një enë hidhni 7 - 8 litra ujë dhe 25 kg produkt. Përzieni me një përzjerës elektrik me numër të vogël rrotullimesh derisa masa të bëhet homogjene pa kokrriza dhe me viskozitetin e deshiruar. Rekomandohet që përzjerja të lihet në qetësi rreth 10 minuta dhe të përzjehet përsëri përpara përdorimit.

### Të Dhënat Teknike

◆ Raporti i Përzieries	6 - 7 litra ujë/25kg
◆ Jetëgjatësia e llaçit	4 orë
◆ Temperatura e aplikimit	+5 deri +35 °C
◆ Ngjyra	E bardhe/ gri
◆ Koha e hapjes	30 min
◆ Konsumi	4 - 5 kg/m <sup>2</sup>
◆ Forma	Pluhur
◆ Paketimi	Thase 25kg
◆ Ruajtja	6 muaj nga data e prodhimit
◆ Rezistenca në shtypje	≥ 10 N/mm <sup>2</sup>
◆ Rezistenca në përkulje	≥ 5 N/mm <sup>2</sup>
◆ Forca e Ngjitjes	≥ 1 N/mm <sup>2</sup>

